



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV.

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja Nr. 68

Prishtinë, më 14.05.2013. filloi në orën 14:30.

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-02

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR TË DREJTAT EDHE INTERESAT E
KOMUNITEEVE DHE KTHIM

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinković, Elmi Reqica, Albert Kinoli, Jasmina Zhivković, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jelena Bontiq, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Mursel Halili

Munguan: Petar Miletiq dhe Glauk Konjufca

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësuesit e OSBE-së, ECMI-it, Ambasadës Zvicërene, Koha Ditore, Kosovapres.

Stafi mbështetës: koordinatori komisionit dhe bashkëpunëtori profesional

Mbledhjen e udhëhoqi, kryetari i komisionit, Goran Marinković

Në mbledhje u propozua ky rend dite.

1. Takimi i Komisionit me Ambadadorin Grek - Dimitris Moschopoulos dhe Z. Rickut Spruyt, me temën :
 - **implementimi i Ligjit për Fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit.**

Kryetari në fjalën hyrëse përshëndeti pjesëmarrësit dhe ambasadorin, të cilët i njoftoi me provesin e planit të veprimit të Grupit të punës për monitorimin e dy ligjeve dhe atë që ka të bëjë me realizimin interesave të caktuara të komuniteteve, me qëllim të mbledhjes së të dhënave të besueshme dhe i informacioneve për zbatimin e ligjit në praktikë. Njëkohësisht i ftoi anëtarët e komisionit që të kyçen në diskutim, të këmbëjnë mendimet, sugjerimet dhe komentet nga pikëpamja e implementimit. Vëmendje të posaçme, kryetari i kushtoi qëllimit kryesor të takimit, pra, faktorëve që ndikojnë në moszbatimin e këtyre dy ligjeve në terren dhe në rëndësisë së trashëgimisë kulturore dhe fetare, zonës së mbrojtur, si dhe përkrahjen më të madhe të të gjithë aktorëve të skenës politike në Kosovë, të organeve qendrore dhe lokale për implementimin dhe mbrojtjen e plotë të tërë trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Jasmina Zhivković – kryetare e Grupit të punës, i informoi të gjithë të pranishmit për formimin e Grupit të punës për mbikëqyrjen e këtyre dy ligjeve dhe për fazën e parë të planit të veprimit. Ajo theksoi se komisioni në këtë drejtim duhet të bashkëpunojë ngushtë me të gjithë faktorët relevant dhe Zyrën e BE-së për të ofruar informacione të nevojshme, mendime, sugjerime dhe të kryejë aktivitete me qëllim të mbledhjes së informacioneve zyrtare dhe të dhënave për nivelin e zbatimit të ligjit, me çështjet të cilat referohen në ligjin ekzistues në fushën mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe fetare. Gjithashtu, ajo theksoi se ekziston gatishmëria dhe vullneti por nuk është punuar sa duhet në zbatimin dhe se është e nevojshme përfshirja e të gjitha potencialeve tona dhe të behet identifikimi se cilat janë problemet dhe vështirësitë që nuk po nuk po implementohet ligjet në afatin e paraparë me ligj. Para së gjithash, a është bërë zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Funkcional të Hoçës së Madhe dhe Këshillit për trashëgimi kulturore të Prizrenit dhe a u janë ndarë mjete të mjaftueshme buxhetore për zgjerimin e kompetencave ?

Jelena Bontić – u falënderua për kohë e ndarë dhe interesimin e ambasadorit dhe këshilltarët e tij që të bisedojnë lidhur me këto dy ligje të rëndësishme, të cilët kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore e fetare të komuniteteve dhe theksoi se njëri nga problemet për zbatimin e këtyre ligjeve është se ka implikime buxhetore, sepse në fazën e përgatitjes së buxhetit nuk janë ndarë mjete të mjaftueshme financiare, gjë që është reflektuar në zbatimin e këtyre ligjeve.

Elmi Reqica, tha se Kushtetuta e Republikës Së Kosovës, Plani i Ahtisarit dhe legjislacioni ekzistues i cili mbulon fushën e mbrojtjes të trashëgimisë kulturore e fetare, si dhe të gjitha subjektet politike e përkrahin këtë proces dhe të atë ngërthen suazat e planeve të ardhshme me qëllim të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore e fetare, menaxhimit dhe zhvillimit të fshatit me status të zonës së mbrojtur me vlerat e interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar. Jemi të gatshëm që të përfshijmë të gjitha mundësitë financiare e operative lidhur me ndarjen e mjeteve për kompetenca shtesë komunave dhe bashkëpunimi me të gjitha palët e interesuara përkatëse për realizimin e plotë të këtij procesi.

Komentimet dhe sugjerimet e ambasadorit Dimitris Moschopoulos

Unë jam për vendosjen e të gjitha formave të bashkëpunimit për hir të koordinimit cilësor me qëllim të zgjidhjes së problemeve të përbashkëta që do të rezultonte me sukses në punën e tërësishme. Qeveria e Republikës së Kosovës është bartëse e krijimit dhe angazhimit në zbatimin e politikave për trashëgiminë kulturore të Kishës Ortodokse Serbe. Për sa i përket përmendoreve të kulturës ekzistojnë disa probleme në nivelin lokal. Në disa nivele ka më shumë transparencë dhe mirëkuptim, kurse në disa janë të pranishme vështirësitë me të cilat do të merremi. Sa i përket këtyre ligjeve, ato nuk janë implementuar në afatin e paraparë rreth formimit të strukturës së Këshillit, posaçërisht me anëtarësinë nga radhët e shoqërisë civile, andaj prapë ashtë shpallur konkursi. Në KK të Rahovecit ende nuk janë zgjedhur anëtarët e Këshillit, sepse në komunë nuk ka pasur zgjedhje dhe autoritete e komunës akoma po hamenden sesi do të bëhet dhe po presin këshilla dhe udhëzime nga Qeveria. Ministria i ka dhënë disa rekomandime, por ka ende paqartësi dhe thonë se u nevojiten sqarime plotësuese. Unë i kam pasur disa takime pune lidhur me aktivitetet e zaonave mbrojtëse. Duhet Ditur se Këshilli Mbikëqyrës ka për detyrë të mbikëqyrë implementimin dhe nëse komuna dhe Kisha Ortodokse Serbe nuk mund të pajtohen për çështje të caktuara, atëherë këto çështje trajtohen në nivel më të lartë AES. Unë si kryesues i Këshillit deri më tash nuk kam hasur në ndonjë vështirësi serioze, sepse janë respektuar dhe përfillur qëndrimet lidhur me mbrojtjen e kishës. Në fund, konstatoi se të gjitha punët po përparojnë me qëllim të zgjidhjes së problemeve dhe theksoi se Grupi i punës duhet të realizojë bashkëpunim të plotë dhe shfaqti shpresën se në periudhën e ardhshme do të shihen rregullisht, të shfaqin mendimet e tyre dhe të merren vesh.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20

Procesverbalin e hartoi:

Njësia mbështetëse e komisionit.

Kryetari i Komisionit

Goran Marinković